



# **BACHELOR**

## **USHQIMI DHE SHKENCAT E TË USHQYERIT**

**NË BASHKËPUNIM ME UNIVERSITETIN BOKU**

# Pse ky program studimi?

Je i/e interesuar të kuptosh se si ushqimi dhe stili i jetesës ndikojnë në shëndetin e njeriut?

Dëshiron të njohësh lidhjen mes zakoneve ushqimore dhe sëmundjeve kronike jo të transmetueshme?

Të tërheq puna në fushën e të ushqyerit, shëndetit publik, edukimit ushqimor apo vlerësimit nutritional?

Dëshiron të kontribuosh në përmirësimin e shëndetit të individëve dhe komuniteteve përmes qasjeve të bazuara në prova shkencore?


**Në këtë rast, programi Bachelor “Ushqimi dhe Shkencat e të Ushqyerit”, i hartuar në bashkëpunim me Universitetin BOKU, ofron formimin e duhur akademik dhe profesional për ndërtimin e karrierës tënde.**

**Diplomë që njihet ndërkombëtarisht**



## Përshkrimi i programit

Një program ndërdisiplinor që kombinon biologjinë, kiminë dhe shkencat shëndetësore për të studiuar ushqimin, të ushqyerit dhe ndikimin e tyre në shëndetin e njeriut. Programi përgatit studentë për profesionet në fushën e të ushqyerit, shëndetit publik, sigurisë dhe cilësisë ushqimore, duke u bazuar në standarde bashkëkohore dhe parimet e zhvillimit të qëndrueshëm.



# Profili i të diplomuarit / Profil profesional

## Nutricionist

I diplomuari formohet si nutricionist me njohuri mbi përbërjen e ushqimeve, parimet e të ushqyerit dhe ndikimin e regjimit ushqimor në shëndetin e njeriut. Është i aftë të kryejë vlerësim nutritional, të hartojë plane ushqimore të personalizuara dhe të ofrojë këshillim nutritional bazë, në përputhje me udhëzime shkencore. Kontribuon në edukimin ushqimor, promovimin e jetesës së shëndetshme dhe parandalimin e sëmundjeve kronike, si në nivel individual ashtu edhe komunitar.

Profili përgatit për angazhim profesional në shëndet publik, projekte ushqyerjeje dhe sisteme ushqimore të qëndrueshme, duke mundësuar punësim në institucione publike, sektorin privat dhe organizata jofitimprurëse.



### **Kliti Rexhepi**

Alumni, Nutricionist

“Studimet në *Ushqimi dhe Shkencat e të Ushqyerit* më kanë ofruar një bazë të fortë shkencore dhe njohuri praktike mbi rolin e ushqyerjes në shëndet, duke më përgatitur për sfidat reale dhe tregun e punës.”



### **Herga Protoduari**

Alumni, Nutricioniste

“Përvoja ime në *Ushqimi dhe Shkencat e të Ushqyerit* ka qenë thelbësore për formimin tim profesional. Programi më ka ndihmuar të kuptoj ushqyerjen në mënyrë të integruar dhe më ka pajisur me aftësi praktike dhe mendim analitik për zhvillim të mëtejshëm në këtë fushë.”



### **Hyrida Basha**

Dietologe Klinike

“Programi *Ushqimi dhe Shkencat e të Ushqyerit* ofron formim shkencor dhe praktik, duke pajisur studentët me aftësi për vlerësim nutritional, planifikim dietetik dhe përmirësimin e shëndetit dhe mirëqenies.”



### **Prof. Dr. Genc Burazeri**

Profesor Universiteti i Mjekësisë  
Tiranë

“Ky program përgatit profesionistë të aftë për të lidhur ushqyerjen me shëndetin dhe sëmundjet kronike, duke kontribuar në parandalim, promovim shëndeti dhe politika efektive për mirëqenien e popullatës.”

# Kompetencat kryesore të fituara

Në përfundim të programit, studentët fitojnë këto kompetenca kryesore:

- Analizë e sistemeve ushqimore dhe vlerësim i ushqyerjes së njeriut.
- Zbatim i parimeve të të ushqyerit në funksion të ruajtjes dhe përmirësimit të shëndetit.
- Vlerësim i cilësisë dhe sigurisë së ushqimeve përgjatë zinxhirit ushqimor.
- Identifikim dhe monitorim i ndotësve, aditivëve dhe kontaminantëve ushqimorë.
- Përdorim i metodave kërkimore, biostatistikore dhe literaturës shkencore.
- Përgatitje për angazhim profesional ndërdisiplinor dhe vazhdim studimesh të avancuara.

## PËRMBAJTJA E STUDIMEVE

### LËNDËT BAZË

Kimi e përgjithshme/  
organike, Biologji,  
Gjenetikë, Hyrje në  
biostatistikë dhe punë  
shkencore

### LËNDËT KARAKTERIZUESE

Ushqim dhe të ushqyerit e  
njeriut, Biokimi, Fiziologji,  
Dietologji, Teknologji  
ushqimore,  
Mikrobiologji dhe Higjienë,  
Shëndet Publik

### TË TJERA

Sociologji e ushqimit,  
Marketingu ushqimor,  
Sisteme ushqimore të  
qëndrueshme, Analiza  
sensoriale, Ligjshmëria  
ushqimore dhe bioetika

Mësimdhënia realizohet përmes leksioneve interaktive, seminareve, ushtrimeve praktike dhe punës laboratorike. Programi përfshin punë laboratorike të strukturuar, projekte studimore dhe praktikë profesionale të detyrueshme

## Mundësi Punësimi:

- Institucionet publike, kërkimore dhe projekte zhvillimi që lidhen me ushqimin dhe shëndetin publik.
- Kompani ushqimore, industri përpunuese dhe shërbime këshillimi në fushën e ushqimit dhe të ushqyerit.
- Pjesëmarrje në ekipe ndërkombëtare që zhvillojnë projekte mbi sistemet ushqimore dhe shëndetin publik.
- Punësim i qëndrueshëm dhe mobilitet në Evropë.

# Të dhënat e programit

## **Niveli i studimit**

Cikli i parë, Bachelor

## **Titulli akademik**

Bachelor në Ushqimi dhe Shkencat e të Ushqyerit

## **Kohëzgjatja**

3 vite akademike / 6 semestra

## **Kredite**

180 ECTS

## **Forma e studimit**

Me kohë të plotë

## **Gjuha e studimit**

Shqip / Anglisht

## **Kuota studimi**

120 studentë

## **Përfundimi i studimeve**

Provimi formimi / Temë diplome



# Rreth UBT

Universiteti Bujqësor i Tiranës u themelua më 1 nëntor 1951 dhe prej vitit 1956 është vendosur në Kodër Kamëz. Që nga krijimi, ai ka qenë një shtyllë e arsimit dhe kërkimit bujqësor në Shqipëri.

Sot, UBT luan një rol kyç në bujqësinë e qëndrueshme, sigurinë ushqimore dhe zhvillimin rural, duke forcuar bashkëpunimin ndërkombëtar përmes partneriteteve strategjike, përfshirë Universitetin BOKU të Vjenës.



## Për më shumë informacion vizitoni:

[www.ubt.edu.al](http://www.ubt.edu.al)

[info@ubt.edu.al](mailto:info@ubt.edu.al)

Rruga "Pajsi Vodica" Tiranë

## MUNDËSI VAZHDIMI STUDIMESH (MASTER)

Të diplomuarit e programit Bachelor "Ushqimi dhe Shkencat e të Ushqyerit" mund të vijojnë studimet në ciklin e dytë Master Shkencor ose Master Profesional në fusha të lidhura me ushqimin dhe të ushqyerit. Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit ofron Masterin Shkencor në "Shkencat e Ushqimit dhe të Ushqyerit", ndërsa studimet Master mund të ndiqen edhe në institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit, sipas kriterëve të pranimit.

## FOLLOW US ON SOCIAL MEDIA



Agricultural University of Tirana



universiteti\_bujqesor\_tiranes  
fbu\_ubt



Universiteti Bujqësor i Tiranës - Faqja Zyrtare  
Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit [U.B.T]

*Për jetën dhe të ardhmen...*